



Në përputhje me Statutin e KPN-së, ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, Ligjin Nr. 06/L-043 për Lirinë e Asocimit në Organizata Joqeveritare i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-244 dhe Ligjin Nr. 08/L-277 për Sport, Kuvendi i Komitetit Paralimpik të Kosovës, në seancën e mbajtur më 23 Korrik 2025, miraton plotësim ndryshimet në Statutin e Komitetit Paralimpik të Kosovës i cili është në dispozicion në gjuhën shqipe dhe angleze.

STATUTI I KOMITETIT PARALIMPIK TË KOSOVËS

PREAMBULA

Përmes kësaj Komiteti Paralimpik i Kosovës (në tekstin e mëtejshëm “KPK”), organizatë që i përket Lëvizjes Paraolimpike, merr përsipër të respektojë dispozitat e Statutit të KPN dhe të Kodit Botëror Anti-Doping dhe t’u përmbahet vendimeve të Komitetit Paralimpik Ndërkombëtar.

KPK-ja merr përsipër, në përputhje me misionin dhe rolin e saj në nivel kombëtar, të promovojë dhe zhvillojë sportin për të gjithë dhe sportin elitë për para sportistët, si dhe të marrë pjesë në Lojërat Paralimpike dhe në veprime për promovimin e paqes dhe barazisë gjinore në sport.

KPK gjithashtu merr përsipër të mbështesë dhe inkurajojë promovimin e etikës sportive, për të luftuar kundër dopingut (bazuar në Kodin Anti-Doping, si ËADA ashtu edhe KPN), të zbatojë Kodin e Klasifikimit të KPN dhe të demonstrojë shqetësim të përgjegjshëm për çështjet mjedisore.

Komiteti Paralimpik i Kosovës është organizata ombrellë e organizatave sportive të personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës, e cila bashkon Federatat, shoqatat e parasportive dhe asociacione tjera, aktivitetet e të cilave kanë rëndësi për promovimin e sportit për personat me aftësi të kufizuara dhe të cilat organizohet në përputhje me standardet paraolimpike dhe parimet ndërkombëtare të lëvizjes Paralimpike dhe ligjet e Republikës së Kosovës.

KPK është ekskluzivisht përgjegjëse për përmirësimin dhe zhvillimin parasportive dhe përfshirjen e integritetit të personave me aftësi të kufizuara në parasporte së bashku me anëtarët e saj në përputhje me Ligjin për sportin.

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1 Qellimi

1.1 Statuti i Komitetit Paralimpik të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm Statuti) rregullon:

- organizimin dhe mënyra e funksionimit, anëtarësimin, mënyren e ushtrimit të të drejtave dhe përgjegjësi të anëtarëve;
- emrin, selin ose adresën e KPK-së ;
- simbolet (forma dhe përmbajtja e logos, simboleve, flamurit dhe stemës) dhe mënyra e përdorimit të tyre;
- qëllimet, detyrat dhe aktivitetet e KPK-së ;
- kushtet dhe mënyra e anëtarësimit dhe përfundimit të anëtarësimit;
- mënyrën dhe procedurat për zgjedhjen dhe shkarkimin e organeve;
- kohëzgjatjen e mandatit dhe kompetencat e organeve, kushtet për organet tjera;;
- metodat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në lidhje me sportin (arbitrazhi); arritjen e transparencës së punës;
- procedurat për përgatitjen dhe miratimin e pasqyrave financiare;
- procedurën për miratimin e statutit, apo ndryshimet e statutit dhe akteve të tjera të përgjithshme;
- çështje të tjera me rëndësi për punën e organizatës sportive.

1.2 KPK nuk lejon diskriminim në bazë racore, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, politikes apo besimeve të tjera, origjinë kombëtare, etnike ose sociale, pronë, anëtarësim në sindikata, sidomos sipas llojit dhe shkakut të paaftësisë dhe cenimit të lirisë dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit.

Neni 2 Perkufizime

1. Komiteti Paralimpik i Kosovës KPK-Organizata kombëtare përgjegjëse për zhvillimin dhe promovimin e sporteve paralimpike në Kosovë. Është anëtare e Komitetit Paralimpik Ndërkombëtar (KPN) dhe përfaqëson sportistët me aftësi të kufizuara në arenën ndërkombëtare .

1.2. Komiteti Paralimpik Evropian KPE-Organizatë Europiane që drejton Lëvizjen Paralimpike në shtetet e Evropës, duke mbështetur Komitetet Paralimpike Kombëtare në Evropë dhe duke promovuar përfshirjen në sportet paralimpike.

1.3. Komiteti Paralimpik Ndërkombëtar KPN-Organizata globale që drejton Lëvizjen Paralimpike dhe organizon Lojërat Paralimpike. KPN promovon barazinë dhe mundësitë e barabarta në sport për personat me aftësi të kufizuara .

1.4. Parasportist-Një sportist me aftësi të kufizuara që merr pjesë në sporte të organizuara sipas klasifikimeve specifike që e karakterizojnë lëvizjen paralimpike.

1.5 Termat e përdorur në këtë Statut që kanë kuptim gjinor referohen njëllë për të dy gjinit. Termi "sport" nënkupton "parasport" ose veprimtari në sportin e personave me aftësi të kufizuara.

Neni 3

Emri, simbolet dhe selia

3.1 KPK është asociacion i pavarur sportiv i cili bashkon të gjitha federatat dhe asociacionet sportive të personave me aftësi të kufizuara.

3.2 KPK-ja është person juridik dhe vepron në territorin e Kosovës. KPK inicion, organizon, drejton dhe kontrollon aktivitetet e të gjitha disiplinave sportive të personave me aftësi të kufizuara dhe aktet normative në përputhje me rregullat e Komitetit Paralimpik Ndërkombëtar (KPN).

3.3 Simboli i KPK-së përbëhet nga një katërkëndësh blu, që brenda përmban hartën e Republikës së Kosovës në ngjyrë të artë, e cila ka pesë unaza cilindrike me ngjyra të ndryshme olimpike dhe shkurtesën KPK poshtë hartës.

3.4 Selia e KPK-së është në Prishtinë, Adresa: Rr. "Tabet e Llapashticës" Nr 35/11 Prishtinë.

3.5 Flamuri i KPK-së ka formën e simbolit të tij (material mëndafshi).

3.6 Vula e KPK-s; është e rrumbullakët dhe katrore me shenjën e KPK-së në mes dhe mbishkrimin: KOMITETI PARALIMPIK I KOSOVËS, në gjuhën dhe angleze.

3.7 KPK është përgjegjëse me të gjitha mjetet e saj për obligimet e marra përsipër: KPK ka llogarinë bankare të cilën e përcakton Bordi Ekzekutiv i KPK-së.

3.8 KPK-ja mund të anëtarësohet në asociacione ndërkombëtare.

3.9 KPK përfaqësohet nga Presidenti/ja ose personi i autorizuar nga Presidenti/ja.

3.10 KPK bashkëpunon dhe vepron me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (Departamentin e Sporteve), si dhe shoqatat e tjera josp sportive të cilat janë të gatshme të bashkëpunojnë.

3.11 Puna e KPK-së do të jetë publike dhe KPK-ja për punën e saj e informon publikun përmes mediave dhe konferencave për shtyp. Ajo i njofton anëtarët e saj përmes:

- Procesverbaleve të mbledhjeve të organeve dhe komisioneve
- Buletineve dhe publikimeve tjera dhe
- Mediave.

Neni 4

Themeluesit

4.1 Themeluesit e Organizatës janë:

- Daut Tishuki Rruga "Azem Bejta" nr.35 Pejë.
- Igballe Potera, Rr. "Nënë Tereza" Ulpianë A2/15 Prishtinë.
- Aziz Nishori Rr."Gjergj Fishta" Nr.9 Lipjan.

Neni 5

Qëllimet dhe Veprimtaritë e KPK-së

5.1 Qëllimet e KPK-së janë: Organizimi, promovimi, shumëfishimi dhe zhvillimi në mënyrë cilësore i sporteve për para sportistët, zhvillimi i garave zyrtare dhe të tjera dhe marrja pjesë në Lojërat Paralimpike.

- Organizimi dhe zhvillimi në mënyrë profesionale i lojtarëve, trajnerëve, gjyqtarëve, vëzhguesve dhe zyrtarëve tjerë.
- Rritja e cilësisë së sporteve paraolimpike në shkallë kombëtare në këtë aspekt dhe promovimi i tyre ndërkombëtarisht.
- Mbështetja e krijimit të federatave kombëtare sportive për të gjitha llojet e para sportistëve dhe përmes tyre organizimi dhe zhvillimi i garave të rregullta për të gjitha kategoritë.
- Përfaqësimi i federatave sportive të para atletëve në institucione ndërkombëtare.
- Marrja pjesë në ngjarje dhe gara ndërkombëtare.
- Marrja pjesë në punën e organizatave të tjera sportive ndërkombëtare, që janë në programin paralimpik.
- KPK-ja vepron si organ drejtues i Kosovës për sportin që qeveriset nga KPN.
- KPK-ja duhet t'i përmbahet detyrimeve të saj si anëtare e KPN, siç parashihet në manualin e KPN.

Vizioni i KPK-së është që të përfshijë dhe angazhojë në sport të gjithë personat me aftësi të kufizuara të Kosovës, që sporti të bëhet stili i tyre i jetesës, të marrin pjesë në Lojërat Paralimpike dhe të shkëlqejnë në podium dhe në jetë. Për ta arritur këtë vizion, KPK-ja duhet t'i përmbahet vlerave themelore dhe objektivave strategjike si dhe atyre të zgjuara (S.M.A.R.T).

Neni 6

Anëtarët e KPK-së

Anëtarët të KPK me te drejta te plota mund të jenë:

6.1 Anëtarë me te drejta te plota janë:

- federatat kombëtare parasportive sipas llojit të sportit;
- federatat kombëtare parasportive sipas llojit të aftësisë së kufizuar;
- asociacionet e parasportive sipas llojit të sportit dhe llojit të aftësisë së kufizuar

6.1.1 Anëtarë të kuvendit të komitetit paralimpik të Kosovës me të drejta të plota janë: Federata e Sporteve për të verber, Federata e Paravolejbollit e Kosovës, Federata e Basketbollit me karroca, Federata e Boccia e Kosovës, Federata e Para-shenjtarisë, Federata e Para-atletikës, Asocacioni i tenisit me karrocë.

6.2 Anëtarët që plotësojnë kriteret e lartpërmendura të anëtarësimit kanë të drejtë të:

- Votojnë dhe të dëgjohen në mbledhjet e Kuvendit
- Nominojnë kandidatët për Bordin Ekzekutiv
- Paraqesin kërkesa dhe të dëgjohen
- Marrin pjesë në të gjitha aktivitetet e KPK-së, me kusht që të përmbushin kriteret e pranueshmërisë së aktivitetit përkatës

Anëtarët kanë për obligim që të:

- Zhvillojnë, promovojnë dhe mbrojnë vizionin dhe aspiratën e KPK-së në përputhje me çdo akt nënligjor, kod, rregullore të KPK-së dhe respektojnë të gjitha vendimet e KPK-së
- Respektojnë autoritetin e KPK-së për të përzgjedhur dhe futur atletët dhe zyrtarët paralimpikë në Lojërat Paralimpike dhe garat e tjera të njohura nga KPN
- Paguajnë anëtarësimin vjetor sipas politikës së përcaktuar në mbledhjen e Kuvendit të KPK-së.

6.3 Kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për anëtarësim në KPK janë si më poshtë:

- Deklarata me shkrim e federatës për aplikimin dhe respektimin e Statutit dhe akteve të tjera normative të KPK-së.
- Certifikata e regjistrimit të Federatës,

- Emrat e personave të autorizuar për përfaqësim,
- Numrin e xhirollogarisë bankare:

6.4 Bordi Ekzekutiv i KPK-së pranon përkohësisht anëtarë të rinj në KPK dhe i propozon Kuvendit njohjen e plotë. Secili anëtar i KPK-së duhet të paguajë anëtarësimin vjetor, të cilin e përcakton Bordi Ekzekutiv i KPK-së.

6.5 Anëtar i mund të largohet nga KPK-ja, kur i përmbush të gjitha detyrimet financiare që i ka KPK-së dhe anëtarëve të saj.

Anëtar mund të përjashtohet nga KPK-ja kur shkel dispozitat e Statutit dhe aktet e tjera normative të KPK-së: nuk zbaton ose shpërfill vendimet e detyrueshme të KPK-së, futet në veprime që dëmtojnë imazhin e KPK-së, kur konstatohet se organizata e lidhur me KPK-në dështon në realizimin e veprimtarisë së saj, ose nuk e ka mbajtur kuvendin gjatë dy viteve të fundit. Vendimin për përjashtim nga anëtarësia e merr Kuvendi, përjashtimi hyn në fuqi nga dita e marrjes së vendimit.

Neni 7

Organet e KPK-së

KPK ka organet e veta të përhershme dhe mund të ketë edhe organe të përkohshme ekspertësh dhe punuese.

Organet e përhershme të KPK janë:

1. Kuvendi,
2. Bordi Ekzekutiv,
3. Presidenti,
4. Komisioni Mbikëqyrës,
5. Komisioni i Etikës.
6. Komisioni Parasportiv

Neni 8

Kuvendi

8.1 Kuvendi është organi më i lartë drejtues i KPK-së, i cili përbëhet nga:

- a. Federata e Sporteve për të Verber, Federata e Paravolejbollit e Kosovës, Federata e Basketbollit në Karroca e Kosovës, Federata e Para Boccia e Kosovës, Federata e Parashenjtarisë të Kosovës, Federata e Para-atletikës e Kosovës, Asocacioni i Para Tenisit me Karroca në Kosovë.

8.2. Anëtarët me të drejta të plota të kuvendit të Komitetit Paralimpik të Kosovës kanë këtë numër të delegatëve:

8.2.1 -Federata e Sporteve për të Verbër e Kosovës dërgon dy përfaqësues për disiplinën e Gollball, dy përfaqësues për disiplinën e Futbollit 5, dy përfaqësues për disiplinën e Judo-së, një përfaqësues për disiplinën e shahut për të verbër, secili me të drejtë vote, me mundësi që të respektohet barazia gjinore. Në total kjo federatë mëqë mbulon 4 disiplina përfaqësohet me shtatë (7) delegatë.

- Federata e Paravolejbollit e Kosovës përfaqësohet me dy (2) delegatë.
- Federata e Basketbollit në Karroca e Kosovës përfaqësohet me dy (2) delegatë.
- Federata e Para Boccia e Kosovës përfaqësohet me dy(2) delegatë.
- Federata e Parashenjtarisë të Kosovës përfaqësohet me dy(2) delegatë.
- Federata e Para Atletikës e Kosovës përfaqësohet me dy(2) delegatë.
- Asocacioni i Para Tenisit me Karroca në Kosovë përfaqësohet me dy(2) delegatë.

Këta përfaqësues (delegatë) duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Të jetë shtetas i Kosovës
- Të jetë i moshës madhore (mbi 18 vjeç)
- Të jetë punëtor i afirmuar i sporteve të aftësisë së kufizuar, pranon statutin e KPK-së.
- Të ftuarit (vëzhguesit) mund të marrin pjesë në mbledhjet e Kuvendit pa të drejtë vote.

8.2 Mbledhjet e Kuvendit mund të jenë të rregullta, zgjedhore dhe të jashtëzakonshme. Mbledhja e rregullt mbahet të paktën një herë në vit dhe thirret nga Presidenti/e KPK-së. Ftesa për mbledhjen e rregullt të Kuvendit duhet të dërgohet jo më vonë se 7 ditë para mbledhjes së Kuvendit, ndërsa materialet duhet të dërgohen tri (3) ditë para mbledhjes së Kuvendit. Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen me prani fizike, online ose ndonjë kombinim i të dyjave.

8.3 Kuvendin e jashtëzakonshëm mund ta thërrasë Presidenti/ja ose anëtarët me të drejta të plota të Kuvendit me 1/3 e delegatëve të të gjithë anëtarëve të kuvendit. Kur të plotësohen kushtet, kuvendi i jashtëzakonshëm duhet të thirret nga Presidenti/ja, në afat prej 30 ditësh nga dita e kërkesës, në të kundërtën, kuvendin e jashtëzakonshëm mund ta thërrasë iniciatori.

8.4 Kuvendi i jashtëzakonshëm mund të jetë edhe zgjedhor nëse delegatët vendosin kështu dhe vendoset vetëm për çështjet për të cilat është thirrur.

8.5 Kuvendi mund të marrë vendime nëse janë të pranishëm më shumë se gjysma (50% + 1) e të gjithë anëtarëve të Kuvendit të KPK-së me të drejta të plota, përveq në rastet e parapara me nenin 8 paragrafi 8.7, paragrafin 8.9 dhe paragrafi 8.13.

8.6 Kuvendi zgjedh Kryesinë, Komisionin Verifikues, procesmbajtësin dhe nëse është e nevojshme, edhe organet tjera punuese.

8.7 Kuvendi merr vendime me shumicën e votave të anëtarëve të të gjithë anëtarëve me të drejta të plota të kuvendit të Komitetit Paralimpik, të cilët kanë të drejtë vote. Kuvendi mund të vendosë për ndryshime statutore ose për shpërbërjen e KPK-së, me votën e 2/3 të anëtarëve të pranishëm. Votimi bëhet publik përveç nëse Kuvendi vendos ndryshe. Kuvendi kryesohet nga Kryesia, e cila përbëhet nga: President e KPK-së dhe dy anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi i Anëtarëve.

8.8 Vendimet e Kuvendit janë të detyrueshme për të gjithë anëtarët dhe organet e KPK-së.

8.9 Procedura dhe mënyra e punës së Kuvendit rregullohet më hollësisht me rregulloren e punës së Kuvendit.

8.10 Kuvendi mund ta revokojë anëtarin e Bordit Ekzekutiv para skadimit të mandatit për të cilin është zgjedhur nëse ai/ajo nuk e ushtron detyrën në përputhje me dispozitat e këtij statuti ose me vendimet e Bordit Ekzekutiv dhe Kuvendit të Anëtarëve.

8.11 Kuvendi mund ta revokojë gjithë Bordin Ekzekutiv kur konstatohet se për shkak të pakujdesisë dhe njohurive të pamjaftueshme në përgatitjen e detyrave dhe përgjegjësisë nga programi i punës së Kuvendit të Anëtarëve dhe Bordit Ekzekutiv, përkatësisht dokumentacioni për shqyrtim në KPK, e ka penguar punën; dhe veprimtaria e Kuvendit të Anëtarëve, ka penguar zbatimin e politikave zhvillimore në fushën e parasportit.

8.12 Shpenzimet për pjesëmarrjen në mbledhjen e Kuvendit të Anëtarëve i bartin vetë anëtarët.

8.13 Kuvendi në kuadër të fushëveprimit të tij kryen këto detyra:

- Shqyrtonë dhe miraton procesverbalin e mbledhjes së mëparshme të Kuvendit
- Shqyrtonë dhe miraton statutin
- Shqyrtonë dhe miraton Rregulloren e Punës së Kuvendit të Anëtarëve
- Shqyrtonë dhe vendos për anëtarësimin e KPK-së në KPN dhe në organizata të tjera ndërkombëtare
- Zgjedh dhe shkarkon Presidentn/en, zëvendës Presidentn/en dhe anëtarët e tjerë të Bordit Ekzekutiv
- Zgjedh dhe shkarkon Këshillin Mbikëqyrës
- Shqyrtonë dhe miraton raportin financiar dhe jo-financiar të vitit të kaluar
- Shqyrtonë dhe miraton Planin Strategjik për secilin cikël paralimpik
- Shqyrtonë dhe Miraton Planin Operativ për vitin e ardhshëm
- Shqyrtonë dhe Miraton buxhetin dhe Planin Financiar për vitin e ardhshëm
- Vendos për ndryshimin e sistemit të garave ne koordinim me federata sportive.
- Vendos për shlyerjen e dënimeve
- Vendos për transferimin e kompetencave te të tjerët
- Kryen edhe punë të tjera në përputhje me Statutin dhe aktet e tjera të KPK-së.

Neni 9

Bordi Ekzekutiv

9.1 Bordi Ekzekutiv (BE) i KPK-së menaxhon punën e KPK-së ndërmjet dy mbledhjeve të Kuvendit të Anëtarëve. Mbledhjet thirren nga Presidenti, ndërsa në mungesë të saj, nga zëvendës Presidenti ose anëtarët e tjerë të bordit ekzekutiv të caktuar nga Presidenti/ja. Mbledhjet janë të rregullta ose të jashtëzakonshme. Mbledhja e jashtëzakonshme mund të thirret nga Presidenti ose nga shumica e anëtarëve të BE së KPK-së.

9.2 Bordi Ekzekutiv i KPK-së mblidhet sipas nevojës të paktën një herë në tre muaj. Mbledhjet e Bordit Ekzekutiv të KPK-së mund të mbahen me prani fizike, online ose ndonjë kombinim i të dyjave.

9.3 Bordi Ekzekutiv i KPK-së i raporton Kuvendit të Anëtarëve të KPK-së për punën e tij.

9.4 Bordi Ekzekutiv i KPK-së ka trembëdhjetë (13) anëtarë dhe përbëhet nga:

- Presidenti
- Zëvendës-Presidenti
- Shtatë (7) anëtarë të tjerë që vijnë nga FK-të si delegatë të kuvendit
- Një (1) parasportist i propozuar nga komisioni parasportiv dhe zgjedhur nga Kuvendi dhe
- Tre (3) anëtarë emërohen nga Presidenti kur ai/ajo konsideron se është me interes strategjik.

9.5 Anëtarët e Bordit Ekzekutiv të KPK-së zgjedhen nga Kuvendi me shumicën e votave për mandat katër vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes. Në Bordin Ekzekutiv përfaqësohen gjithashtu pakicat dhe gratë. Bordi Ekzekutiv është organi ekzekutiv i KPK-së.

9.6 Anëtarët e Bordit zgjedhen me votim të fshehtë. Kuvendi mund të vendosë që anëtarët e BE zgjedhen me votim të hapur ose me aklamacion nëse për një post ka vetëm një kandidat.

9.7 Anëtarët e KPK-së duhet të dërgojnë me shkrim listën me delegatët e nominuar duke plotësuar Formularin përkatës të KPK. Formulari përfshin emrat e kandidatëve dhe propozimet për pozitat e tyre në Bordin Ekzekutiv. Kandidati i nominuar për njërën pozitë nuk mund të nominohet për pozitë tjetër. President i Bordit Ekzekutiv është edhe President i Kuvendit.

9.8 Mënyra e punës dhe procedura e vendimmarrjes në Bordin Ekzekutiv të KPK-së rregullohet më hollësisht me Rregulloren e punës së Bordit Ekzekutiv.

9.9 Në kuadër të fushëveprimit të tij, Bordi Ekzekutiv kryen këto detyra:

- I propozon Kuvendit të Anëtarëve Statutin dhe akte të tjera
- Përgatit mbledhjet e Kuvendit të Anëtarëve dhe materialet shoqëruese

- Ekzekuton vendimet e Kuvendit të Anëtarëve
- Miraton listën e personave zyrtarë që përfaqësojnë KPK-në në garat ndërkombëtare
- Merr vendimin për hartimin e Planit strategjik për Ciklin Paralimpik të rradhës
- Harton planin operativ dhe atë financiar të KPK-së
- Vendos për blerjen ose shitjen e aseteve të KPK-së
- Përcakton shumën e kuotës së anëtarësimit për federatat, anëtarët e KPK-së
- Vendos për pranimin e punonjësve dhe bashkëpunëtorëve në KPK dhe për nivelin e pagave dhe mëditjeve të tyre.
- Emëron dhe shkarkon anëtarët e përhershëm dhe ata ad-hoc të komisioneve

9.10 Komisionet e përhershme dhe ato ad-hoc i raportojnë anëtarëve të Bordit Ekzekutiv për punën e tyre.

9.10.1 Komisionet e përhershme janë:

- a. Komisioni i parasporteve (sipas udhëzimeve të KPN-së)
- b. Komisioni i Etikës

9.10;2 Komisionet ad-hoc janë:

- c. Komisioni i Financës dhe Auditimit
- d. Komisioni Ligjor
- e. Komisioni i Marketingut
- f. Komisioni Mjekësor
- g. Komisioni i Marrëdhënieve Ndërkombëtare

Neni 10

Presidenti

10.1 President mund të zgjidhet një person që i plotëson kriteret e mëposhtme:

- të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
- të ketë mbushur moshën madhore
- të jetë veprimtar i respektuar dhe i dalluar
- të zotërojë rrjedhshëm njërën nga dy gjuhët zyrtare të KPN-së,
- të mos i ketë shkelur normat etike dhe parimet morale të lëvizjes Paralimpike,
- të pranojë këtë statut,
- të jetë delegat i Kuvendit.

10.2 Presidenti i KPK-së mund të propozohet nga federata kombëtare që është në programin e Lojërave Paralimpike dhe që është anëtare me të drejta të plota e KPK-së si dhe nga Bordi Ekzekutiv.

10.3 Kandidati për president duhet të ketë 5 nënshkrime nga delegatët e Kuvendit.

10.4 Presidenti zgjedhet me votim të fshehtë, përjashtimisht kur për President është vetëm një kandidat. Në këtë rast aplikohet votimi me ngritje të dorës ose me aklamacion.

10.5 Presidenti i propozon kuvendit zvendës presidentin i cili zgjedhet me votim të fshehtë. Kuvendi mund të vendosë që Zvendës Presidenti të zgjedhen me votim të hapur ose me aklamacion nëse ka vetëm një kandidat.

10.6 Mandati i Presidentit është katër vjet me mundësi rizgjedhjeje, pas përfundimit të çdo cikli paralimpik.

10.7 Presidenti, në kuadër të fushëveprimit dhe kompetencave të tij/saj, kryen këto detyra:

- Presidenti i KPK-së ka rol ekzekutiv dhe është përfaqësues i autorizuar i KPK-së, thërret seancat e Bordit Ekzekutiv, kryeson Bordin Ekzekutiv dhe seancat e Kuvendit.
- Përfaqëson KPK-së në takimet vendore dhe ndërkombëtare.
- Propozon anëtarët e delegacionit të KPK-së dhe drejtuesit e udhëtimeve për takime dhe gara ndërkombëtare.
- Nënshkruan vendimet e marra nga Bordi Ekzekutiv dhe Kuvendi.
- Siguron zbatimin e plotë të planit strategjik, planit operativ dhe planit financiar.
- Merr vendime në rrethana të jashtëzakonshme kur Bordi Ekzekutiv nuk mund të mbledhet dhe i njofton këto organe sa më shpejtë që të jetë e mundur ose e organizon mbledhjen online.
- Ka të drejtë pas marrjes së raportit nga komisioni i etikës të pezullojë çdo anëtar të Bordit Ekzekutiv deri në mbledhjen e rradhës së kuvendit të anëtarëve kur vendoset përmes procesit të votimit, nëse ai/ajo nuk është aktiv ose nuk vepron në frymën e akteve normative të KPK-së dhe objektivave të tij.
- Presidenti i raporton Kuvendit të KPK-së.
- Presidenti mund të shkarkohet edhe para skadimit të mandatit zgjedhor kur e humb besimin ose me kërkesë të tij/saj.
- Për zgjedhjen dhe shkarkimin e Presidentit, Kuvendi vendos me votën e mbi 2/3 të të gjithë delegatëve të cilët janë anëtare me të drejta të plota të kuvendit të KPK-së.
- Kryen detyra të tjera sipas nevojës dhe në bazë të të kërkesave nga Kuvendi ose Bordi Ekzekutiv.

Sekretari/ja dhe Arkatari/ja

11.1 Sekretari/ja propozohet nga Presidenti/ja e KPK-së dhe miratohet nga Bordi Ekzekutiv me shumicë votash.

11.1.1 Sekretari duhet ti plotësojë kushtet e mëposhtme:

- të ketë formim profesional (njohës i para sporteve)
- të ketë aftësi kompjuterike
- të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze ose frënge
- të ketë njohuri për formën e funksionimit të federatave dhe klubeve parasportive.

11.2 Në kuadër të fushëveprimit të tij/saj sekretari kryen këto detyra:

- Përcjell punën e zyrës së KPK-së.
- Ne koordinim me Presidentin/en ekzekuton vendimet e Kuvendit të KPK-së, të Bordit Ekzekutiv dhe të Komisioneve.
- Koordinon bashkëpunimin e KPK-së me federatat para sportive si dhe me KPN-në.
- Bashkëpunon me Departamentin e Sportit dhe organizatat tjera sportive në Kosovë.
- Përgatitë mbledhjet e Kuvendit dhe Bordit Ekzekutiv.
- Merr pjesë në të gjitha mbledhjet e organeve dhe komisioneve të KPK-së në cilësi të këshilltarit pa të drejtë vote.
- Mban kontakte me mediat.
- Kryen edhe punë të tjera që rrjedhin nga aktet e tjera normative të KPK-së.

11.3 Kur Sekretari/ja i KPK-së konstaton se aktet e përgjithshme ose çfarëdo akti bie ndesh me legjislacionin në fuqi, ose me Statutin e KPK-së, ai/ajo është i detyruar të paralajmërojë dhe informojë Presidentin/ën dhe Bordin Ekzekutiv.

11.4 Sekretari/ja mund të i nderpriet marëdhënia e punës edhe para skadimit të kontratës në formën e njejtë si është zgjedhur, me propozimin e Presidentit/ës dhe me miratimin e Bordit Ekzekutiv të KPK-së, në rastet si vijon:

Nëse me punën e tij/saj vepron:

- në kundërshtim me ligjet në fuqi në Kosovë,
- në kundërshtim me statutin dhe aktet e tjera të KPK-së,
- në kundërshtim me imazhin e KPK-së dhe të shoqërisë në përgjithësi,
- në kundërshtim me vendimet e Presidentit/ës dhe Bordit Ekzekutiv,
- me kërkesën e tij, në rast pensionimi dhe vdekjeje.

11.5 Në rast të mungesës së tij/saj pa arsye të qendrueshme, Sekretari/ja i/e KPK mund të zëvendësohet si Ushtrues Detyre nga personi i propozuar nga Presidenti/ja dhe i/e miratuar nga

Bordi Ekzekutiv, deri në miratimin e Arkatarit/ës të ri/re të KPK. Arkatari/ja duhet të respektoj Statutin dhe të gjitha aktet tjera të brendshme të KPK.

11.6 Sekretari/ja i/ KPK përgatit dhe merr pjesë në të gjitha mbledhjet e Bordit Ekzekutiv me të drejtë diskutimi, por pa të drejtë vote.

11.7 Arkatari/ja propozohet nga Presidenti/ja e KPK-së dhe miratohet nga Bordi Ekzekutiv me shumicë votash.

11.7.1 Arkatari duhet ti plotësojë kushtet e mëposhtme:

- të ketë formim profesional në fushën e ekonomisë dhe menaxhimit të financave në bazë të ligjeve të aplikueshme në Kosovë,
- të ketë aftësi kompjuterike,
- të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze ose frënge,
- të ketë njohuri për formën e funksionimit të federatave dhe klubeve parasportive.

11.8 Arkatari/ja në kuadër të fushëveprimit të tij/saj kryen këto detyra:

- Arkatari/ja duhet ti depozitoj te gjitha fondet e pranuar nga KPK në llogarinë e KPK-së, në emër dhe si kreditim i KPK, ashtu sic është aprovuar nga Presidenti/ja i KPK,
- Arkatari/ja do të autorizohet në llogarinë KPK-së, nga Presidenti/ja i/e KPK-së,
- Arkatari/ja duhet të mbaj në rregull, sakte dhe të përditësuara të gjitha të dhënat për shpenzimet, të hyrat dhe transaksionet tjera financiare të KPK të disponueshme në çdo kohë për Presidentin/ën dhe Bordin Ekzekutiv të KPK-së.
- Arkatari/ja duhet të përgatis të gjitha raportet dhe buxhetet vjetore për Presidentin/ën, Bordin Ekzekutiv dhe për Kuvendin e Anëtarëve të KPK-së, por, duhet të përgatisë edhe raportet tjera të kërkuara në bazë të nevojës në periudha mujore apo periudha tjera të kërkuara nga strukturat e KPK-së.
- Arkatari/ja duhet të siguroj se gjendja financiare e KPK është audituar në rregull dhe për çdo vit, nga Auditori i zgjedhur nga Kuvendi i Anëtarëve të KPK-së.
- Arkatari/ja duhet të kryej edhe funksione tjera kohe pas kohe ashtu si i përshkruhen nga Kuvendi i Anëtarëve, nga Bordi Ekzekutiv, ose nga Presidenti/ja.

11.9 Kur Arkatari/ja i/e KPK-së vëren se aktet e përgjithshme ose çfarëdo akti bie ndesh me legjislacionin në fuqi, ose me Statutin e KPK-së, ai/ajo është i detyruar të paralajmërojë Presidentin/ën dhe Sekretarin/ën.

11.10 Arkatari/ja mund të i nderprties marëdhënia e punës edhe para skadimit të kontratës në formën e njëjtë si është zgjedhur, me propozimin e Presidentit/ës dhe me miratimin e Bordit Ekzekutiv të KPK-së, në rastet si vijon:

Nëse me punën e tij/saj vepron:

- në kundërshtim me ligjet në fuqi në Kosovë,
- në kundërshtim me statutin dhe aktet e tjera të KPK-së,
- në kundërshtim me imazhin e KPK-së dhe të shoqërisë në përgjithësi,
- në kundërshtim me vendimet e Presidentit/ës dhe Bordit Ekzekutiv,
- me kërkesën e tij, në rast pensionimi dhe vdekjeje.

11.11 Në rast të mungesës së tij/saj pa arsye të qendrueshme, Arkatari/ja i/e KPK mund të zëvendësohet si Ushtrues Detyre nga personi i propozuar nga Presidenti/ja dhe i/e miratuar nga Bordi Ekzekutiv deri në miratimin e Arkatarit/ës të ri/re të KPK. Arkatari/ja duhet të respektoj Statutin dhe të gjitha aktet tjera të brendshme të KPK.

Neni 12

Komisioni Mbikëqyrës

12.1 Komisioni Mbikëqyrës përbëhet nga 3 anëtarë. Komisioni Mbikëqyrës zgjedhet nga Kuvendi për mandat katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje për një mandat shtesë.

12.2 Anëtari i Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të jetë anëtar i Bordit Ekzekutiv të KPK-së.

12.3 Bordi Ekzekutiv detyrohet që t'ia lejojë Komisionit Mbikëqyrës të mbikëqyrë punën e tij. Komisioni Mbikëqyrës monitoron punën e organeve të Kuvendit të Anëtarëve ndërmjet dy mbledhjeve të Kuvendit dhe mbikëqyrë aspektet financiare të KPK-së.

12.4 Komisioni Mbikëqyrës i raporton Kuvendit të Anëtarëve të KPK-së për punën e tij. Mënyra e punës së Komisionit Mbikëqyrës përcaktohet më hollësisht në Rregulloren e Punës së Komisionit Mbikëqyrës.

Neni 13

Komisionet e përhershme dhe ato ad-hoc

13.1 Komisionet e Përhershme përbëhen nga tre anëtarë të emëruar nga Kuvendi i KPK-së për mandat katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat.

13.2. Komisionet ad-hoc përbëhen nga tre apo më shumë anëtarë të emëruar nga Bordi Ekzekutiv i KPK-së.

13.3. Qëllimi dhe detyrat e komisioneve të KPK-së janë këshillimi i Bordit Ekzekutiv, përveq Komisionit Mbikëqyrës i cili funksionon në bazë të Nenit 12 të Statutit të Komitetit Paralimpik të

Kosovës dhe Rregulloren e Punës së Komisionit Mbikëqyrës. Të gjitha vendimet në Komisione merren me shumicë votash (50% + 1). Komisionet mund të marrin vendime nëse në mbledhje janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve.

Neni 14

Ekipi kombëtar

14.1 KPK-ja obligohet të kujdeset për punën e Kombëtares dhe të sigurojë kushtet më të mira të mundshme të punës brenda kapaciteteve financiare. KPK-ja mund të miratojë rregullore të veçanta për punën e ekipeve kombëtare.

14.2 Përzgjedhësit e Kombëtares zgjedhen nga Bordi Ekzekutiv i KPK-së me propozimin e federatave përkatëse. Mandati i tyre është katër vjet, me mundësi rizgjedhjeje.

14.3 Trajnerët e ekipit kombëtar nominohen nga përzgjedhësi dhe emërohen nga Bordi Ekzekutiv i KPK-së.

14.4. Komisioni i parasportit bashkpunon në menyrë të ngushtë me Bordin Ekzekutiv për perzgjedhjen e ekipit kombëtar.

Neni 15

Asetet dhe fondet

15.1 KPK-ja financohet nga:

- Departamenti i Sportit i MKRS-së
- Shuma e kuotës së anëtarësisë
- Sponzorimet bazuar në legjislacionin aktual për sponzorizime në fushën e sportit.
- Donacionet e personave fizikë dhe juridikë
- Marketingu.
- Të ardhurat nga garat, dhe
- Burime të tjera të lejuara me ligj.

15.2 Presidentii KPK-së është përgjegjës për çështjet financiare të KPK-së, bazuar në planin financiar dhe vendimet e Kuvendit të Anëtarëve dhe Bordit Ekzekutiv të KPK-së. Për të ndihmuar në zhvillimin e veprimtarisë të KPK-së, mund të punësohet zyrtari financiar në përputhje me Ligjin e Punës.

15.3 KPK-ja mund të marrë në posedim pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, Bordi Ekzekutiv vendos për blerjen dhe shitjen e aseteve, kalimin e tyre te një person tjetër juridik ose dhënien e tyre me qira.

Neni 16

Shërbimet Profesionale

16.1 Për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësiwe profesionale, materialo-financiare, administrative-teknike dhe të tjera për zbatimin e programeve dhe veprimtarive të KPK-së, organeve dhe grupeve të punës së saj, krijohet Shërbimi Profesional me numrin e nevojshëm të personave fizik apo juridik. Orari dhe puna e Shërbimit Profesional përcaktohet nga rregullorja për sistemimin e vendeve të punës për Shërbimin Profesional.

16.2 Të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë reciproke të punonjësve të Shërbimit Profesional dhe të KPK-së rregullohen me një kontratë, e cila lidhet nga punonjësit e Shërbimit Profesional dhe perfaqesuesin e autorizuar të KPK-së në përputhje me ligjin e punës .

16.3 Shërbimi profesional i KPK-së drejtohet nga Presidenti i KPK-së, i cili koordinon shërbimin profesional dhe Bordin Ekzekutiv dhe kryen detyra tjera të përcaktuara me aktet e përgjithshme të KPK-së.

16.4 Punonjësit e Shërbimit Profesional të KPK nuk mund të mbajnë poste ekzekutive dhe funksione në organet e KPK dhe as delegat në Kuvend.

Neni 17

AKADEMIA PARALIMPIKE E KOSOVËS

17.1 KPK-ja mund të themelojë Akademinë Paralimpikë të Kosovës nën ombrellën e KPK-së.

17.1 Akademia Paralimpikë e Kosovës funksionon në përputhje me termat specifike të referencës së miratuar nga KPK-ja.

Neni 18

Rregulloret e brendshme

18.1 Rregulloret e brendshme miratohen në kuvendin e anëtareve të KPK-së.

18.2 Mjetet juridike të zakonshme dhe të jashtëzakonshme mund të përdoren në procedurën administrative që zhvillohet nga organet kompetente të KPK-së. Për çështjet administrative të cilat nuk rregullohen me këtë Statut, zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Neni 19

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

19.1 Ky statut hyn në fuqi në ditën e miratimit të amendamenteve nga mbledhja e Kuvendit të Anëtarëve të KPK-së. Me hyrjen në fuqi të këtij statuti nuk zbatohet më statuti i miratuar më 20.01.2022.

19.2 Aktet e përgjithshme të KPK-së, si dhe aktet e tjera të sportit me aftësi të kufizuara, duhet të harmonizohen brenda 90 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij statuti.

19.3 Në rast se ky statut has në ndonjë pikë kundërshtim me Ligjin për lirinë e Asocimit, Ligjin për Sport, Ligjin për parandalimin e dhunës në sport dhe aktet nënligjore që rrjedhin nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, vlejné dispozitat e akteve të lartëcekura.

Neni 20

Ndryshimet në Statut

20.1 Ky Statut në versionet e gjuhës angleze dhe shqipe mund të ndryshohet me vendim të dy të tretave të Kuvendit të Anëtarëve, duke respektuar legjislacionin në fuqi.

20.2 Çdo ndryshim i Statutit duhet t'i nënshtrohet miratimit nga KPN-ja.

Njomza Emini, President

